01-715

| | | |
|---|---|---|
| | **Republika e Kosovës**<br>Republika Kosova – Republic of Kosovo<br><br>**Komuna e Prishtinës**<br>Opština Priština –Municipality of Prishtina | PRISHTINA |

Në bazë të nenit 22, 44, 50 dhe 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-03, dt. 21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës nr.110-391 dt. 25.02.2010, pikës 9 të nenit 13 të Udhëzim Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe në bazë të kërkesës 05nr.350/03–55177/24 dt.29.04.2024, të kërkuesit: Subjektit juridik & Investitorit "Bautrade"sh.p.k. nga Ratkoci-Rahoveci, me certifikatë të biznesit ARBK 810734154, dhe me pronarë Xhevat Kastrati nga dhe Demush Daki nga Prishtina, për ***ndryshim – plotësim*** të aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, të lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesve: Pronarëve, Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama nga Prishtina me Investitor "Bau Trade"sh.p.k., me seli në Ratkoc-Rahovec, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për lejimin e ndërtimit të kompleksit të shtëpive individuale të banimit, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0 & 963-0 ZK Bërnicë e Epërme, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt për vendosjen e çështjes administrative, me dt.21.05.2024, merr këtë:

## V E N D I M

**NDRYSHIM-PLOTËSIMI I VENDIMIT TË KUSHTEVE NDËRTIMORE, 05NR.350/02–131507/21 DT.16.03.2022**

**I. Miratohet** kërkesa 05nr.350/03–55177/24 dt.29.04.2024, në emër të kërkuesit: Subjektit juridik & Investitorit "Bautrade"sh.p.k. nga Ratkoci-Rahoveci, me certifikatë të biznesit ARBK 810734154, dhe me përfaqësues Xhevat Kastrati nga Ratkoci dhe Demush Daki nga Prishtina, për ***ndryshim – plotësim*** të aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, të lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesve: Pronarëve, Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama nga Prishtina me Investitor "Bau Trade"sh.p.k., me seli në Ratkoce-Rahovec, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0 & 963-0 ZK Bërnicë e Epërme, konkretisht për ndërtimin e ndërtesave individuale banimore / shtëpive familjare – 20 shtëpi individuale të banimit në varg, nga këto 6 shtëpi me P+1, 10 shtëpi me etazhitet B+P+1, dhe 4 shtëpi me etazhitet P+1+Nk.;

**II. Ndryshim-plotësimi** i aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, ka të bëjë me ricaktimin e kushteve ndërtimore për parcelën kadastrale nr. 1598-16 ZK Bërnicë e Epërme *(e formuar pas bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0 & 963-0 ZK Bërnicë e Epërme)*, me pronar "Bautrade" shpk, me sipërfaqe S=371m², dhe me lloj të shfrytëzimit "tokë ndërtimore".

**III. Parcela kadastrale** nr. 1598-16 ZK Bërnicë e Epërme, sipas projektit konceptual -"zgjidhja urbane", të prezantuar, dhe e cila shtrihet në grupacionin prej 10 shtëpive banimore *(sipas kushteve ndërtimore të përcaktuara paraprakisht)*, është propozuar të ndahet në dy parcela të reja, me sipërfaqe S=185+186=371m², dhe duke planifikuar ndërtimin e një ndërtese individuale banimore – shtëpi dyshe, me etazhitet B+P+1+Nk, përkatësisht duke propozuar rritjen e shputës (ISHP-së) për 10 %, me aplikim të arkitekturës së qëndrueshme, bazuar në kriteret e përcaktuara në Vendimin e Kryetarit të Komunës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015;

**IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe për ndërtimin e ndërtesës individuale – shtëpi dyshe, me Hyrja "1" dhe "2", me etazhitet B+P+1+Nk, bazuar në parametrat urban të Planit Zhvillimor Urban, dhe të Vendimit të Kryetarit të Komunës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, janë si në vijim:

- Në kuadër të kompleksit me ndërtesa individuale banimore, përkatësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1598-16 ZK Bërrnicë e Epërme, është planifikuar të ndërtimi i një ndërtese individuale banimore-shtëpi dyshe, me Hyrja "1" dhe Hyrja "2", me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projekt propozimit, si në vijim:

**Hyrja "1"** - S=222.95 m² / 148.20 m², mbi tokë + 74.75 m², nën tokë /
Etazhitet: B+P+1+Nk
**Ndërtesa "2"** - S=222.95 m² / 148.20 m², mbi tokë + 74.75 m², nën tokë /
Etazhitet: B+P+1+Nk
**Sipërfaqja e përgjithshme S=445.90 m² / 296.40 m², mbi tokë + 149.50 m², nën tokë /.**

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazën/gabarit të përdheses ose suterenit, sipas planit në kuadër të PZHU-së, lejohet max.30%, ndërsa me aplikim të arkitekturës së qëndrueshëm, bazuar në Vendimin 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, lejohet rritja për 10 %, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
S=185 x 0.4=74.00m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "1" /;
S=186 x 0.4=74.40m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "2" /;
S= 63.95m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "1" /;
S= 63.95m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "2" /;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore / parcelave të bashkuara (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
S=185 x 0.6=111.00m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "1" /;
S=186 x 0.6=111.60m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "2" /;
S= 74.75m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "1" /;
S= 74.75m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "2" /;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore / parcelave të bashkuara, për hapësira gjelbëruese (ISHPGJ), bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është min.40%, dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
S=185 x 0.4=74.00m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "1" /;
S=186 x 0.4=74.40m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "2" /;
S= 81.20m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "1" /;
S= 81.20m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "2" /;
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas sipas planit në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, indeksi i siperfaqes ndertimore 0.6-08 – llogaritet, si në vijim: ***100%*** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi ***51%*** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - ***suteren***, dhe ***0%*** për etazhet e nëntokës – ***bodrum***, dhe sipas llogarive kjo sipërfaqe është:
S=185 x 0.8=148.40m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "1" /;
S=186 x 0.8=148.40m² / për shtëpi dyshe - Hyrja "2" /;
S=148.20m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "1" /;
S=148.20m² / sipas projekt propozimit konceptual për Hyrja "2" /;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efiçiencës së energjisë, duke aplikuar kriteret e përcaktuara në Vendimin e Kryetarit të Komunës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, për arkitekturë të qëndrueshme;

**V. Ndarja /** parcelimi i parcelës kadastrale 1598-16 ZK Bërnicë e Epërme, do të realizohet bazuar në Plani i situacionit - "zgjidhja urbane", dhe manualin e ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike "Ar Consulting"sh.p.k. nga Prishtina, me licencë nr.72.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtij vendimi, për ***ndryshim-plotësim*** të kushteve ndërtimore, dhe me

kërkesë të pronarit, duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

**VI. Me dokumentacionin** tjetër të nevojshëm për aplikim për leje ndërtimore të prezantohet edhe elaborati i "Arkitektura e qëndrueshme", i hartuar bazuar në kriteret e përcaktuara në Vendimin e Kryetarit të Komunës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015;

**VII. Ky vendim** është pjesë përbërëse e aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

## Arsyetim

Kërkuesit: Subjekti juridik & Investitori "Bautrade"sh.p.k. nga Ratkoci-Rahoveci, me certifikatë të biznesit ARBK 810734154, dhe me pronarë Xhevat Kastrati dhe Demush Daki nga Prishtina, 05nr.350/03–55177/24 dt.29.04.2024, kanë këkuar nga kjo drejtori, ***ndryshim – plotësim*** të aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, të lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesve: Pronarëve, Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama nga Prishtina me Investitor "Bau Trade"sh.p.k., me seli në Ratkoc-Rahovec, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për lejimin e ndërtimit të kompleksit të shtëpive individuale të banimit, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0 & 963-0 ZK Bërnicë e Epërme.

Me kërkesën 05nr.350/03–55177/24 dt.29.04.2024, për ***ndryshim-plotësim*** të aktit administrativ *"Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore"*, 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, si dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni si në vijim:

- *Dëshmia mbi pronësinë e parcelës kadastrale nr.1598-16 ZK Bërnicë e Epërme, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinë;*
- *Projekti konceptual - "zgjidhja urbane" me projekt ideor të ndërtesave individuale banimre-shtëpisë dyshe, hartuar nga "Eko Building Project" sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të biznesit 811374454;*
- *Manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar "Ar Consulting"sh.p.k. nga Prishtina, me licencë nr.72;*
- *Fotokopja e pa vërtetuar e "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, të lëshuara nga kjo drejtori;*
- *Fotokopja e pa vërtetuar e "Vendim Leje ndërtimi për ndërtimin e ndërtesave të banimit individual / shtëpi familjare të Tipit "A"-dy (2) shtëpi me B+P+1, Tipi "B"-katër (4) shtëpi me B+P+1 dhe Tipi "C" – tri (3) shtëpi me B+P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban - PZHU në Prishtinë", 05nr.351/02-199903/22 dt.14.12.2022, lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikata e biznesit të subjektit juridik "Bautrade"sh.p.k., me seli në Ratkoc-Rahovec, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810734154*
- *Fotokopja e letërnjoftimit të pronarëve.*
- *Shkresa "Informim" me situacion të parcelave kadastrale me vijë rregullues dhe ndërtimore nga PZHU në sistemin koordinativ KosovaREF 05nr.351/03 – 47122/21 dt.12.04.2021, lëshuar nga kjo drejtori.*

Drejtoria e Urbanizimit, pas pranimit të kërkesës së lartcekur, konsultimit të dosjes së lëndëve paraprake të zhvilluara nga arkivi i drejtorisë, konkretisht dosjen e lëndës – kërkesës për caktim të kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 131507/21 dt.07.07.2021, dhe të dosjes së lëndës – kërkesës për leje ndërtimore 05nr.351/02-199903/22 dt.19.08.2022, si dhe konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, në mënyrë kronologjike konstatoi se:

Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në kërkesën 05nr.350/02 – 131507/21 dt.07.07.2021, të kërkuesve: Pronarëve, Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama nga Prishtina me Investitor "Bau Trade"sh.p.k., me seli në Ratkoc-Rahovec, me aktin administrativ *"Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore"*, 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, ka caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, në kuadër të të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0 & 963-0 ZK

Bërnicë e Epërme, konkretisht për ndërtimin e ndërtesave individuale banimore / shtëpive familjare – 20 shtëpi individuale të banimit në varg, nga këto 6 shtëpi me P+1, dhe 10 shtëpi me etazhite B+P+1 dhe 4 shtëpi me P+1+Nk, në kuadër PZHU-së në Prishtinë.

Subjekti juridik - pronari & Investitori "Bautrade"sh.p.k. nga Ratkoci-Rahoveci, me certifikatë të biznesit ARBK 810734154, dhe me përfaqësues Xhevat Kastrati dhe Demush Daki nga Prishtina, me kërkesën 05nr.350/03–55177/24 dt.29.04.2024, ka kërkuar nga kjo drejtori, miratimin e ***ndryshim - plotësimit*** të aktit administrativ *"Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore"*, 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, të lëshuar nga kjo drejtori, përkatësisht ricaktimin e kushteve ndërtimore për parcelën kadastrale nr. 1598-16 ZK Bërnicë e Epërme *(e formuar pas bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0 & 963-0 ZK Bërnicë e Epërme)*.

Kjo drejtori, pas pranimit të kërkesës për ***ndryshim-plotësim*** të aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02 – 131507/21 dt.16.03.2022, , me dokumentacion të prezantuar, shqyrtimit të përmbajtjes së saj dhe konsultimit të dokumentit të planifikimit hapësinor për atë hapësirë –PZHU-së, si dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, për arkitekturë të qëndrueshme, konstatoi se ka bazë ligjore për miratimin e kërkesës, andaj edhe ka filluar procedurat për trajtimin e saj. Bazuar në projekt propozimin konceptual konstatohet se është propozuar, që parcela ndërtimore nr. 1598-16 Z Bërnicë e Epërme, të ndahet në dy parcela të reja, me sipërfaqe S=185+186=371m², dhe është planifikuar ndërtimi i një ndërtese individuale banimore – shtëpi dyshe, me etazhitet B+P+1+Nk, duke propozuar rritjen e shputës (ISHP-së) për 10 %, me aplikim të arkitekturës së qëndrueshme, bazuar në kriteret e përcaktuara në Vendimin e Kryetarit të Komunës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015.

Kjo drejtori pas pranimit të kërkesës së lartcekur, konsultimit të aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02 – 131507/21 dt.16.03.2021, ka konstatuar se zbatimi i kushteve ndërtimore ka filluar, dhe se me Vendim 05nr.351/02-199903/22 dt.14.12.2022, të lëshuar në emër kërkuesve: Bashkëpronarëve Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama nga Prishtina, me Investitor "Bau Trade"sh.p.k. me seli në Ratkoc-Rahovec, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810734154, dhe me përfaqësues, Halil Hoti, është lejuar ndërtimi i ***Kompleksi "Elite Villas"*** me ndërtesa individuale banimore – shtëpi familjare / nëntë (9) shtëpi - sipas tipeve: **"Tipi "A"** – dy (2) shtëpi, me B+P+1, **Tipi "B"** – katër (4) shtëpi, me B+P+1 dhe **Tipi "C"** – tri (3) shtëpi, me B+P+1 (*të gjitha shtëpi në varg – (Faza* 2), në kuadër PZHU-së në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.**1598**-1, 2, 3, 17, 18, 19, 20, 21 & **nr.1598**-22 ZK Bërrnicë e Epërme, dhe se nuk ka pengesa ligjore dhe të planifikimit për miratimin e kërkesës për ***ndryshim – plotësim*** të kushteve ndërtimore për parcelën nr. 1598-16 ZK Bërnicë e Epërme, sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, në dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, pas konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenin 13 të *"Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve"*, si dhe duke u bazuar në diskrecionin për vendosje të çështjeve të planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, në nenin 21, 44, 50 dhe 84, të LPPA-së Nr.05/L - 031, lidhur me ligjshmërinë për ***ndryshim-plotësim*** të *"Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore"*, 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, konstatoi se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se janë plotësuar kushtet për miratim të kërkesës 05nr.350/03–55177/24 dt.29.04.2024, në emër të kërkuesit: subjektit juridik - Investitorit "Bautrade"sh.p.k. nga Ratkoci-Rahoveci, për **ndryshim-plotësim** të aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022, të lëshuar nga kjo drejtori, në emër të kërkuesve: Pronarëve, Bashkim, Sabri dhe Bekim Rama nga Prishtina me Investitor "Bau Trade"sh.p.k., me seli në Ratkoc-Rahovec, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.962-4, 964-0 & 963-0 ZK Bërnicë e Epërme, përkatësisht për ricaktimin e kushteve ndërtimore për parcelën ndërtimore nr. 1598-16 ZK Bërnicë e Epërme, sipas projekt propozimit konceptual - Plani i situacionit / "zgjidhja urbane" të prezantuar në këtë drejtori, përmes këtij vendimi, e i cili vendim do të jetë pjesë përbërëse e vendimit të kushteve ndërtimore të lartcekura.


Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242, E-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të ***ndryshim-plotësim*** të kushteve ndërtimore.

**Shtojcë: Plani i situacionit** – "zgjidhja urbane" e **ndryshim – plotësim** të aktit administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore", 05nr.350/02–131507/21 dt.16.03.2022 dhe Manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar "Ar Consulting"sh.p.k. nga Prishtina, me licencë nr.72;
**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.
**Shtojcë:** Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e ndërtesës individuale – shtëpi dyshe, me Hyrja "1" dhe "2", me etazhitet B+P+1+Nk, dhe Manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike "Ar Consulting"sh.p.k. nga Prishtina, me licencë nr.72.
**Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje dhe i dërgohet:** Kërkuesit/investitorit, kësaj Drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe vendoset në dosjen e lëndës, 05nr.350/03–0055177/24 dt.29.04.2024 dhe 05nr.350/02–131507/21 dt. 07.07.2021.
**I dërgohet përmes postës elektronike**: Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Planifikim Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**
**05 NR.350/02–131507/21 DT.21.05.2024,**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini,

Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi,


Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242, E-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosova**
*QeveRia -Vlada-Government*
*MinistRia e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelaRija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 1598-16

Zona kadastrale / Katastarska zona: Bërnicë e Epërme

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500

## Propozim per ndarje te parceles




| Koordinatat e parceles bazë | | |
|---|---|---|
| Nr | Y | X |
| 1 | 7513606.893 | 4729747.131 |
| 2 | 7513611.304 | 4729770.559 |
| 3 | 7513624.449 | 4729771.268 |
| 4 | 7513622.409 | 4729743.593 |
| Koordinatat e propozimit per ndarje | | |
| 5 | 7513623.336 | 4729756.169 |
| 6 | 7513609.099 | 4729758.845 |

Rilevoi / Snimio: "AR CONSULTING" SH.P.K
(emRi dhe mbiemRi i gjeodetit kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 72

NënshkRimi / Potpis:

Data e Rilevimit / Datum snimanja: 12/03/2024

KOMPANI E LICENCUAR GJEODETE SH.P.K AR CONSULTING Nr. Lic. 72 Prishtinë

Aprovoi / Usvojio: ____________________
(emRi dhe mbiemRi i përsonit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

NënshkRimi / Potpis: ____________________

Data e aprovimit / Datum usvajanja: ____________________




Legjenda:

Vendimi i Lejes Ndertimore
05 nr.351/02-111010/22 dt.26.07.2022
Tipi -"D" 4 shtepi
Tipi -"E" 6 shtepi.

Vendimi i Lejes Ndertimore
05 nr.351/02-199903/22 dt.14.12.2022
Tipi -"A" 2 shtepi
Tipi -"B" 4 shtepi.
Tipi -"C" 3 shtepi

| PROJEKTI IDEOR | HYRJA 1 | HYRJA 2 | TOTAL |
|---|---|---|---|
| BODRUMI | 74.75 | 74.75 | 149.5 |
| PERDHESA | 63.95 | 63.95 | 127.9 |
| KATI 1 | 52.22 | 52.22 | 104.44 |
| NENKULMI | 32.03 | 32.03 | 64.06 |
| Mbi toke | 148.2 | 148.2 | 296.4 |
| Nen toke | 74.75 | 74.75 | 149.5 |
| Total | 222.95 | 222.95 | 445.9 |

FIRMA PROJEKTUESE:

EKO BUILDING PROJECT

EKO
EKO BUILDING PROJECT
PRISHTINË

Objekti Pika, Mati 1
Prishtine, Kosove, 10000
ekobuildingproject@gmail.com
+383 49 375 238

**Shtëpi Dyshe**
**B+P+1+NK**

Destinimi: Shtëpi Banimi
Vendi: Prishtinë
Investitor: Bau Trade Sh.p.k
Adresa: Bërnicë
Numri i parcelës: **Nr.P.1598-16**

Emri i vizatimit:
**Situacioni (2)**

Niveli i projektit-FAZA:
**Projekti kryesor**

Projektoi: Blerina Tanushaj
Kontrolloi: Blerina Tanushaj

| Perpjesa: | Formati: |
|---|---|
| 1:200 | A3 |
| Data: 5/21/2024 | Numer: 2 |